



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 165, Datë 19.07.2018

MBI

MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA” SH.P.K, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE ME NR. 322, SERIA F15, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 159 DATË 28.12.2015

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i nryshuar, neneve 13 dhe 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 109, datë 29.06.2016, nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 19.07.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për pranimin e kërkesës së shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., për modifikimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE, me Vendimin nr. 159, datë 28.12.2015 ka licencuar shoqërinë “Le Trading Albania” sh.p.k, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5 vjeçar, dhe subjekti është mbajtës i licencës nr. 322, Seria F15.
- Subjekti “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 400 Prot., datë 17.05.2018, ka bërë më dije se, shoqëria “Le Trading Albania” sh.p.k ka ndryshuar emrin e subjektit dhe atë tregtar si më poshtë:
Emri i ri i subjektit bëhet: “Energia Gas and Power Albania”
Emri i ri tregtar bëhet: “Energia Gas and Power Albania”
- Në vijim të korrespondencës sipërcituar, ERE me shkresën nr. 400/1 Prot., datë 25.05.2018, i ka bërë më dije subjektit se, ndryshimet e bëra emrit të subjektit dhe të reflektuara në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, duhet të reflektohen edhe në Licencën e Furnizimit të Energjisë Elektrike me nr. 322 Seria F15.

- Subjekti ka detyrimin që në zbatim të nenit 43 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të aplikojë në ERE për modifikimin e licencës.
- Sa më sipër, subjekti “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k, me shkresën nr. 436 Prot. i ERE, datë 07.06.2018, ka përcjellë në ERE kërkesën për modifikimin e licencës së Furnizimit të energjisë elektrike duke kërkuar ndryshimin e emrit të mbajtësit të saj nga “Le Trading Albania” sh.p.k, në “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 137, datë 25.06.2018, filloi procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k, për modifikimin e licencës së furnizimit me energji elektrike me nr. 322 Seria F15 të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 159, datë 28.12.2015.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE me shkresën nr. 55/39 Prot., datë 26.06.2018, bëri njoftimin në median e shkruar mbi fillimin e procedurës për këtë modifikim si dhe me shkresën nr. 436/2 Prot., datë 05.07.2018, bëri me dije subjektin për fillimin e procedurës dhe i’u kërkuar të depozitojë dokumentacionin e munguar.
- Subjekti “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k”, me shkresën nr. 436/4 Prot., datë 10.07.2018, ka përcjellë në ERE, dokumentacionin e munguar, i cili konsiston në vendimin e Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë sipërcituar.
- Aplikimi i shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:
 - Neni 9, pika 1. Formati dhe dokumentacioni për aplikim,
 - gërma “a” (të dhënat për aplikim), plotësuar.
 - gërma “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesin), plotësuar.
 - gërma “c” (të dhëna për aplikuesin), plotësuar.
 - Neni 8 pika 2. Aplikuesi do të kryejë pagesën për aplikim në momentin e paraqitjes së aplikimit, përcaktuar në aneksin A të kësaj rregulloreje, në shumën 30 000 lekë, plotësuar.
 - Neni 15, pika 4, gërma “a”. Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës, plotësuar.
 - Neni 15, pika 4, gërma “b”. Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence, plotësuar.
 - Neni 15, pika 4, gërma “c”. Miratimi i modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera. Nuk aplikohet në këtë rast kjo kërkesë e rregullores, pasi nga subjekti është bërë vetëm ndryshimi i emrit.
 - Neni 15, pika 4, gërma “d”. Ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit. Modifikimi që po kryhet nuk prek detyrimet e të licencuarit sa i përket mbarëvajtjes së punës për llojin e aktivitetit.

- Neni 15, pika 4, gërma “e”. Të ketë plotësuar pagesat e rregullimit në ERE, plotësuar.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., për modifikimin e licencës së Furnizimit të Energjisë Elektrike nr. 322, Seria F15, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 159 datë 28.12.2015.
2. Në titull dhe përmbajtje të licencës nr. 322, Seria F15, emërtimi “Le Trading Albania” sh.p.k., do të zëvendësohet me emërtimin “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k.
3. Ngarkohet Drejtorja e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.